

V E N D I M
Nr. 343, datë 11.7.2002

**PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE JURIDIKË,
PUBLIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative, të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtuesit e institucioneve shtetërore apo dhe të personave të tjerë juridikë, publikë, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor.

2. Ky shërbim mund t'u ofrohet me dalje ndërkombëtare dhe pa kufizim në përballimin e shpenzimeve nga buxheti i institucionit funksionarëve, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Përfituesve të shtojcës nr.2 u përballohen shpenzimet në masën jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa të tjerëve jo më shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

3. Këto institucione ose persona juridikë, publikë, janë të lira të lidhin kontratat, pa afat ose me afat (kartë telefonike) për këtë shërbim me cilindo prej operatorëve telefonikë, që veprojnë në vend, të cilët kanë epërsi në përmbushjen e këtyre kushteve:

- ofrojnë çmimin më të ulët;
- cilësinë më të mirë;
- shtrirjen më të gjerë të mbulimit me sinjal.

4. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë një udhëzim të posaçëm, për të përcaktuar raportin e shpenzimeve për këtë shërbim me ato operative, si dhe për të përcaktuar kufizime në parashikimin e shpenzimeve vjetore për këtë shërbim.

5. Vendimi nr.248, datë 25.3.1996 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit dhe kategorisë së telefonave celularë në përdorim të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

SHTOJCA NR.1

Presidenti i Republikës
Kryetari i Kuvendit
Kryeministri
Kryetari i Gjykatës së Kushtetuese
Kryetari i Gjykatës së Lartë
Prokurori i Përgjithshëm
Zëvendëskryetari i Kuvendit
Zëvendëskryeministri
Ministri

Sekretari i Përgjithshëm në Presidencë, Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave
Drejtori i Kabinetit të Presidentit të Republikës, i Kryetarit të Kuvendit dhe i Kryeministrit,
si dhe çdo funksionar i barazuar me ta në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe a të barabartë me atë që i përgjigjet funksionit të pikës 11.

SHTOJCA NR.2

Zëvendësministri
Sekretari i Përgjithshëm në ministri
Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme,
si dhe çdo funksionar i barazuar me ta në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe a të
barabartë me atë që i përgjigjet funksionit të pikës 3.

V E N D I M